



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 134 Prot.

Tiranë, më 24. 01. 2019

V E N D I M

Nr. 13, Datë 24. 01. 2019

Mbështetur në ligjin Nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa Nr. 124, datë 16.08.2018, e shtetasit A. H., kundër Albpetrol sh.a., në të cilën pretendohet për diskriminim *për shkak të ankimit¹ të bërë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Fier.*

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Ankuesi A. H., shpjegon se ka mbajtur detyrën e drejtorit të Drejtorisë Juridike pranë administratës së Albpetrol sh.a, prej datës 04.11.2013 deri më datë 15.01.2018. Me vendimin nr. 14, datë 15.01.2018, të Albpetrol sh.a, ankuesit i është zgjidhur kontrata e punës dhe është liruar nga detyra e Drejtorit të Drejtorisë Juridike duke kaluar në pozicionin e specialistit të Drejtorisë Juridike, pranë Administratës së shoqërisë Albpetrol sh.a. Për këtë, ankuesi i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Fier më datë 17.04.2018, me pretendim diskriminimin për shkak të bindjeve politike, ku Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është thirrur si palë e tretë në proces.

Me shkresën Nr. 6122 prot., datë 18.07.2018, Shoqëria Albpetrol, ka bërë me dije ankuesin se, referuar Raportit të Kontrollit të Lartë të Shtetit të vitit 2017, Nr. 576/44, datë 31.12.2017 (protokolluar në Albpetrol me Nr. 916, datë 02.02.2018), është debitor në vlerën 308,000 lekë, për periudhën Mars 2016-Dhjetor 2017, për përfitim të pagesës për titullin Master Shkencor, në mënyrë të padrejtë.

¹ Ankim me pretendim diskriminimin për shkak të bindjeve politike nga Albpetrol sh.a.

Përsa më lart, ankuesi pretendon se për periudhën e audituar nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit, përfitues të shpërblimit në pagë, për gradat shkencore (Doktoraturë, Master Shkencor dhe Profesional), kanë qënë punonjësit:

1. E. P., për periudhën 01.10.2016-31.12.2016, në shumën 42.000 lekë.
2. F. G., për periudhën 01.10.2016-31.12.2016, në shumën 75.000 lekë.
3. A. H., për periudhën 01.10.2016-31.12.2016, në shumën 42.000 lekë.
4. D. F., për periudhën 01.10.2016-31.12.2016, në shumën 42.000 lekë.
5. E. F., për periudhën 01.10.2016-31.12.2016, në shumën 33.000 lekë.
6. J. Gj., për periudhën 01.10.2016-31.12.2016, në shumën 33.000 lekë.
7. O. K., për periudhën 01.10.2016-31.12.2016, në shumën 42.000 lekë.
8. Th. M., për periudhën 01.10.2016-31.12.2016, në shumën 42.000 lekë.

Në total, shuma e përfituar nga 8 (tetë) punonjësit e sipërcituar për periudhën e audituar, ka qënë 351.000 lekë, ndërsa vetëm A. H. i kërkohet të kthej një detyrim prej 308.000 lekësh.

Sipas ankuesit, punonjësit që janë marrë me zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, qëllimisht nuk i kanë dërguar njoftim brenda një afati 6-mujor, punonjësve të tjerë debitor, në mënyrë që këto detyrime të mos kthehen më në buxhetin e Shoqërisë Albpetrol, duke iu referuar parashikimeve të nenit 203/3 të Kodit të Punës, ku përcaktohet se: *“Punëdhënësi heq dorë nga e drejta për të kërkuar zhdëmtimin e dëmit të shkaktuar nga punëmarrësi, në qoftë se nuk e kërkon këtë të drejtë me shkrim brenda gjashtë muajve nga dita e marrjes dijeni”*.

Ne këto kushte, duke mos njoftuar deri më datë 02.08.2018, punonjësit debitor, për kthimin e detyrimeve të konstatuara nga KLSH, Shoqërisë Albpetrol sh.a., i humb e drejta për të kërkuar kthimin e dëmit të shkaktuar nga punëmarrësit.

Në përfundim, ankuesi pretendon se është trajtuar në mënyrë të pafavorshme dhe diskriminuese, në formën e viktimizimit, nga ana e Shoqërisë Albpetrol sh.a., në raport me 7 (shtatë) punëmarrësit e tjerë debitor, për shkak të ankimit të bërë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Fier. Në zbatim të ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të konstatojë situatën diskriminuese dhe të marrë të gjitha masat e nevojshme në përpjestim me gjendjen që i ka shkaktuar asaj, duke i vendosur sanksion me gjobë.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen*

shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së², në pikën 1 të tij, parashikon se: “ Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10 221/2010, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32, pika 2 dhe 33, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Pas analizimit të ankesës, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Në vijim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me anë të shkresës nr. 1144/1 prot., datë 24.08.2018, kërkoi informacion³ lidhur me pretendimet e subjektit ankues nga ana e Shoqërisë Albpétrol sh.a.

Përsa më lart, me anë të shkresës⁴ me Nr. 8123/1 prot., datë 07.09.2018, Albpétrol ka vënë në dispozicion të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi një pjesë të informacionit të kërkuar, duke theksuar ndër të tjera se: “Vlera e përfituruar nga ish punonjësi A. H., rezulton të jetë në kundërshtim me VKM-në Nr. 545, datë 11.08.2011, ndryshuar me VKM-në 524, datë 16.08.2012 dhe evidentuar nga KLSH në Raportet e Auditit të Shoqërisë Albpétrol sh.a. Patos, për periudhat 2016/2017. Në raportet përkatëse evidentohet fakti se: “Për miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, referenca në këtë VKM e Urdhërit Nr. 703, datë 10.12.2014 i Administratorit, është e gabuar. Ky vendim u referohet nëpunësve civil të

² Shkurtesë për ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

³ - Informacion mbi pretendimet e ngritura në ankesë nga ana e shtetasit A. H.

- Informacion dhe kopje të Raportit të KLSH-së (vetëm faqet ku konstatohet dëmi ekonomik për shkak të shpërblimit për gradat shkencore).

- Kopje të shkresave, në të cilat u kërkohet punonjësve debitor të Shoqërisë Albpétrol sh.a., të kthejnë dëmin ekonomik që i ka ardhur buxhetit të shoqërisë, si pasojë e shpërblimit për gradat shkencore. (Nëse janë realizuar këto njoftime).

⁴ Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 1144/2 prot., datë 11.09.2018

administratës publike dhe nuk përbën detyrim për punonjësit e shoqërive aksionare, marrëdhëniet e punës të cilave bazohen në Kodin e Punës. Gjithashtu kjo VKM përcakton se: Kjo shtesë jepet kur kualifikimi, grada, titulli shkencor përputhen me përshkrimin e punës së nëpunësit...” (paragrafi i dytë i pikës c) dhe në asnjë rast në rregulloren e brendshme të funksionimit të Albpetrol sh.a., asnjë pozicion pune nuk kërkon zotërimin e kualifikimit, gradës apo titullit shkencor. Pra duke u nisur nga fakti i mësipërm, KLSH-ja në rekomandimet e lëna urdhëron arkëtimin e shumave të përfituara nga këta punonjës, si rrjedhojë e dëmit ekonomik të shkaktuar ndaj shoqërisë Albpetrol sh.a. Administratori i shoqërisë në zbatim të rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja, me vendim Nr. 226, datë 04.04.2018 me lëndë “Për anulimin e vendimit Nr. 703, datë 10.12.2014”, në pikën 1 urdhëron, “Të ndërpriten të gjitha pagesat shtesë mbi pagë për të gjithë punonjësit përfitues”, gjithashtu në pikën 4 të këtij urdhëri parashikohet kryerja e të gjitha procedurave administrative dhe gjyqësore për kthimin e këtyre shumave.”

Në vijim të përgjigjes, Albpetrol sh.a., sqaron se ankuesi është njoftuar me shkresën Nr. 4537 prot., datë 29.05.2018, për debinë, si dhe me shkresën Nr. 6122 prot., datë 13.07.2018, është njoftuar për shlyerjen në mënyrë vullnetare të detyrimit që ka ndaj shoqërisë.

Lidhur me kërkesën e KMD-së për vënien në dispozicion të shqyrtimit të çështjes: “Kopje të shkresave, në të cilat u kërkohet punonjësve debitor të Shoqërisë Albpetrol sh.a., të kthejnë dëmin ekonomik që i ka ardhur buxhetit të shoqërisë, si pasojë e shpërblimit për gradat shkencore. (Nëse janë realizuar këto njoftime).”, në shkresën e sipërcituar Shoqëria Albpetrol sh.a. sqaron se: “Përsa i përket arkëtimin të shumave ndaj debitorëve të tjerë, është një çështje që nuk ka lidhje me objektin e ankesës”.

- Referuar në nenin 32, pika 2 të ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ku citohet: “Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin komisionerin në përmbushjen e detyrave të tij, veçanërisht duke i dhënë informacionin që i nevojitet atij”, me anë të shkresës nr. 1144/5 prot., datë 26.09.2018, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kërkuar informacion nga ana e Shoqërisë Albpetrol sh.a., lidhur me: “Kopje të shkresave, në të cilat u kërkohet punonjësve debitor të Shoqërisë Albpetrol sh.a., të kthejnë dëmin ekonomik që i ka ardhur buxhetit të shoqërisë, si pasojë e shpërblimit për gradat shkencore. (Nëse janë realizuar këto njoftime)”.

Në përgjigje të saj, Shoqëria Albpetrol sh.a., nuk ka vënë në dispozicion informacionin e kërkuar.

- Duke qënë se informacioni i dhënë nga Shoqërisë Albpetrol sh.a., nuk ishte i plotë, atëherë për shqyrtimin e mëtejshëm të saj, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vendosi të realizojë një seancë dëgjimore mes palëve. Për këtë me anë të shkresave Nr. 1373 prot., datë 05.10.2018 dhe Nr. 1386 prot., datë 09.10.2018, Komisioneri pasi mori miratimin e palëve në proces, njoftoi zhvillimin e seancës dëgjimore më datë 15.10.2018.

Në seancë dëgjimore si përfaqësues të palës ndaj së cilës është paraqitur ankesa, ishin prezent: përfaqësuesja e Shoqërisë Albpetrol sh.a.⁵ dhe ankuesi.

Në vijim të seancës dëgjimore, u sqaruan shkurtimisht nga pala ankuese pretendimet për diskriminim të ngritura ndaj Shoqërisë Albpetrol sh.a., duke kërkuar konstatimin e diskriminimit për shkak të *ankimit*⁶ të bërë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Fier.

Nga ana e përfaqësueses së Shoqërisë Albpetrol sh.a., u sqarua se 7 (shtatë) punonjësit⁷ e tjerë janë njoftuar nga punëdhënësi më datë 27.09.2018, për kthimin e detyrimeve të cituara në dy raportet e KLSH-së⁸. Lidhur me detyrimin prej 308.000 lekësh, të ankuesit, u sqarua se kjo ka ardhur si shumatore e dëmit të konstatuar në dy raportet e KLSH-së. Sa i përket datës 24 Shtator 2018, kur janë njoftuar debitorët e tjerë, përfaqësuesja e Albpetrol sh.a. sqaroi se nga ana e KLSH-së nuk u ishte lënë një afat i caktuar për kthimin e detyrimeve. Gjithashtu, u shtua se tre nga personat e njoftuar më datë 27.09.2018, ishin ende punonjës të shoqërisë dhe në dijeninë e saj nuk kishte persona të tjerë të kenë paditur shoqërinë lidhur me kthimin e dëmit të konstatuar në raportet e KLSH-së.

Në përgjigje të pretendimeve të ngritura nga ana e përfaqësueses së Albpetrol sh.a., ankuesi parashitroi se, qëllimisht nuk u është dërguar njoftim brenda një afati 6-mujor punonjësve të tjerë debitor, në mënyrë që këto detyrime të mos kthehen më në buxhetin e Shoqërisë Albpetrol, duke iu referuar parashikimeve të nenit 203/2 të Kodit të Punës, ku përcaktohet se: *“Punëdhënësi heq dorë nga e drejta për të kërkuar zhdëmtimin e dëmit të shkaktuar nga punëmarrësi, në qoftë se nuk e kërkon këtë të drejtë me shkrim brenda gjashtë muajve nga dita e marrjes dijeni”*. Me një fakt të tillë, Shoqëria Albpetrol sh.a., ishte përballur edhe më parë, sipas ankuesit, pasi kishte humbur një proces tjetër gjyqësor, ku për shkak të njoftimit jashtë afateve, punonjësit debitor ndaj kompanisë nuk kanë kthyer më detyrimet e prapambetura.

Në mbështetje të pretendimeve të ngritura gjatë seancës dëgjimore, ankuesi me shkresën datë 16.10.2018, protokolluar pranë KMD-së me Nr. 1432, datë 18.10.2018, vuri në dispozicion të KMD-së prova shtesë. Bashkëngjitur shkresës ankuesi vuri në dispozicion kopje të Vendimeve të Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit Vlorë, në të cilat Shoqëria Albpetrol sh.a., ka humbur proceset gjyqësore, për shkak të njoftimit jashtë afateve dhe punonjësit debitor ndaj kompanisë nuk kanë kthyer më detyrimet e prapambetura.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

⁵ Shtetasit E. P., F. G., D. F., E. F., J. GJ., O. K., TH. M.

⁶ Ankim me pretendim diskriminim për shkak të bindjeve politike nga Albpetrol sh.a.

⁷ Nga përfaqësuesja e Albpetrol sh.a., u vunë në dispozicion të KMD-së, kopje të shkresave

⁸ Shkurtesë e Kontrollit të Lartë të Shtetit

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e pabarabartë ose të pafavorshëm.

Ankuesi A. H., ka mbajtur detyrën e drejtorit të Drejtorisë Juridike pranë administratës së Albpetrol sh.a., prej datës 04.11.2013 deri më datë 15.01.2018 Me vendimin nr. 14, datë 15.01.2018, i është zgjidhur kontrata e punës dhe është liruar nga detyra e Drejtorit të Drejtorisë Juridike duke kaluar në pozicionin e specialistit të Drejtorisë Juridike, pranë Administratës së shoqërisë Albpetrol sh.a. Për këtë, i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Fier, me pretendim diskriminim për shkak të bindjeve politike, ku Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është pjesë e procesit si palë e tretë.

Mbështetur në provat e administruara, Administratori i Shoqërisë Albpetrol sh.a., me Vendimin Nr. 703, datë 10.12.2014, ka përcaktuar që punonjësit e shoqërisë të cilët punojnë në adiministratën qendrore të shoqërisë të përfitojnë shpërbllim në pagë sipas titujve shkencor. Gjatë kontrolleve të ushtruara nga KLSH, në vitet 2016 dhe 2017, është konstatuar se pagesat e gradave shkencore janë kryer në mënyrë të kundraligjshme dhe nisur nga ky fakt, në rekomandimet e lëna ka urdhëruar arkëtimin e shumave të përfituara nga këta punonjës, si rrjedhojë e dëmit ekonomik të shkaktuar ndaj shoqërisë Albpetrol sh.a. Administratori i shoqërisë në zbatim të rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja, me vendim Nr. 226, datë 04.04.2018 me lëndë *“Për anullimin e vendimit Nr. 703, datë 10.12.2014”*, në pikën 1 ka urdhëruar, *“Të ndërpriten të gjitha pagesat shtesë mbi pagë për të gjithë punonjësit përfitues”*, si dhe në pikën 4 të këtij urdhëri është parashikuar kryerja e të gjitha procedurave administrative dhe gjyqësore për kthimin e këtyre shumave.

Fillimisht, me shkresën Nr. 6122 prot., datë 18.07.2018, Shoqëria Albpetrol, ka bërë me dije vetëm ankuesin se, referuar Raportit të Kontrollit të Lartë të Shtetit të vitit 2017, Nr. 576/44, datë 31.12.2017 (protokolluar në Albpetrol me Nr. 916, datë 02.02.2018), është debitor në vlerën 308,000 lekë, për periudhën Mars 2016-Dhjetor 2017, për përfitimin e pagesës për titullin Master Shkencor, në mënyrë të padrejtë.

Në një moment të dytë, me datë **27.09.2018**, pra në të njëjtën ditë janë njoftuar shtatë punonjësit e tjerë pjesë e raportit të KLSH:

1. Me shkresën Nr. 9271 prot., ish punonjësi i shoqërisë E. P., për kthimin e shumës 392.000 (treqind e nëntëdhjetë e dy mijë) lekë.
2. Me shkresën Nr. 9275 prot., ish punonjësi i shoqërisë F. G., për kthimin e shumës 480.000 (katërqind e tetëdhjetë mijë) lekë.
3. Me shkresën Nr. 9272 prot., punonjësi i shoqërisë D. F., për kthimin e shumës 420.000 (katërqind e njëzet mijë) lekë.

4. Me shkresën Nr. 9273 prot., punonjësja e shoqërisë E. F., për kthimin e shumës 233.000 (dyqind e tridhjetë e tre mijë) lekë.
5. Me shkresën Nr. 9276 prot., ish punonjësi i shoqërisë J. Gj., për kthimin e shumës 165.000 (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekë.
6. Me shkresën Nr. 9277 prot., ish punonjësi i shoqërisë O. K., për kthimin e shumës 308.000 (treqind e tetë mijë) lekë.
7. Me shkresën Nr. 9274 prot., punonjësi i shoqërisë Th. M., për kthimin e shumës 336.000 (treqind e tridhjetë e gjashtë mijë) lekë.

Në nenin 203/2 të Ligjit Nr. 7961, datë 12.7.1995 *“Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”*, përcaktohet se: *“Punëdhënësi heq dorë nga e drejta për të kërkuar zhdëmtimin e dëmit të shkaktuar nga punëmarrësi, në qoftë se nuk e kërkon këtë të drejtë me shkrim brenda gjashtë muajve nga dita e marrjes dijani”*.

Nga informacioni dhe provat e administruara, Shoqëria Albpetrol sh.a., është vënë në dijeni të Rekomandimeve të KLSH-së, lidhur me kthimin e detyrimeve të përfituara nga punonjësit, më datë 02.02.2018, në momentin e protokollimit. Pra, sipas parashikimit të sipërcituar në Kodin e Punës, afati përfundimtar për të njoftuar punonjësit debitor nda shoqërisë ka qënë data 02.08.2018. Nga sa konstatohet nga provat e administruara, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vëren se njoftimi i punonjësve dhe ish punonjësve të Shoqërisë Albpetrol sh.a., përveç ankuesit, lidhur me zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së është bërë në të njëjtën datë (27.09.2018) dhe pas përfundimit të afatit 6-mujor të parashikuar në Kodin e Punës.

Gjithashtu, nga provat e vëna në dispozicion nga ana e ankuesit, Shoqëria Albpetrol sh.a., në vitin 2015 i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë Fier me kërkesë padi⁹, nëpërmjet së cilës ka kërkuar kthimin e dëmit financiar të shkaktuar ndaj saj, nga tre punonjës. Në përfundim të arsyetimit të saj, Gjykata e Shkallës së Parë Fier, lënë në fuqi¹⁰ edhe nga Gjykata e Apelit Vlorë, ka vendosur¹¹ rrëzimin e kërkesë padisë së Shoqërisë Albpetrol sh.a., ndër të tjera me arsyetimin se: *“...duke iu referuar përmbajtjes së nenit 203/2 të Kodit të Punës, vlerëson se paditësi Albpetrol sh.a., Patos, ka hequr dorë nga e drejta për të kërkuar zhdëmtimin e dëmit nga të paditurit punëmarrës, duke qënë se nuk e ka kërkuar këtë të drejtë brenda afatit gjashtë mujor nga dita që ka marrë dijeni për dëmin e shkaktuar nga shkaktuesit e tij. Kjo e drejtë është shuar dhe nuk mund të kërkohej më rivendosja e saj nëpërmjet gjykatës...”*.

Nga procedura hetimore, rezultoi se Shoqëria Albpetrol sh.a., veç ankuesit, nuk kishte njoftuar asnjë punonjës apo ish punonjës për zhdëmtimin e dëmit të shkaktuar deri në momentin që ankuesi ka paraqitur ankesë tek Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

⁹ Nr. xxxxx-01365-62-xxxx (xxxx) Rregj. Them., datë 09.06.2015

¹⁰ Me vendim Nr. xxxx, datë 02.11.2017

¹¹ Nr. 62-xxxx-xxxx (xxxx), datë 24.11.2015

Në këto kushte, duke mos njoftuar deri më datë 02.08.2018, punonjësit debitor, për kthimin e detyrimeve të konstatuara nga KLSH, Shoqërisë Albpetrol sh.a., i humb e drejta për zhdëmtimin e dëmit të shkaktuar nga punëmarrësit.

Përsa më lart, fakti që punonjësit e tjerë të Shoqërisë Albpetrol sh.a., janë njoftuar përtej afateve ligjore për kthimin e dëmit të shkaktuar dhe në të njëjtën datë, krijon dyshimin e arsyeshëm se ky veprim ka qënë i paramenduar, si dhe është bërë në mënyrë që këta punonjës të mos kthejnë dëmin e shkaktuar shoqërisë. Duke qënë se kthimi i dëmit të shkaktuar, i është kërkuar brenda afateve vetëm ankuesit, krijohet dyshimi i arsyeshëm i trajtimit të tij në mënyrë të pabarabartë, në raport me punonjësit e tjerë të Shoqërisë Albpetrol sh.a., me të cilët ndodhet në të njëjtat kushte. Nga ana tjetër rezulton se gjithsesi veprimi i Shoqërisë Albpetrol sh.a kundrejt ankuesit nuk është i paligjshëm, përkundrazi ai është bërë brenda parashikimeve ligjore.

B. Shkaku i mbrojtur.

Mbështetur në nenin¹² 2 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj.

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se subjekti ankues i pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “*shkakun e mbrojtur*”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet subjektit ankues dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Ankuesi pretendon se është trajtuar në mënyrë diskriminuese dhe të pabarabartë, nga ana e Shoqërisë Albpetrol sh.a. për shkak të *ankimit*¹³ të bërë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Fier, shkak i cili është i parashikuar në nenin 1 të Ligjit Nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Gjatë trajtimit të ankesës së A. H., u administruan prova dhe argumenta se ankuesi disponon shkakun e mbrojtur, atë të ankimit kundër Shoqërisë Albpetrol sh.a. më datë 17.04.2018, pranë

¹² Neni 2: “Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminim.”

¹³ Ankim me pretendim diskriminimin për shkak të bindjeve politike nga Albpetrol sh.a.

Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Fier, me objekt diskriminimin për shkak të bindjeve politike, gjatë procedurave të largimit nga puna.

C. Lidhja e trajtimit të pabarabartë dhe të pafavorshëm me shkakun e mbrojtur.

Për të vërtetuar faktin se ankuesi është ekspozuar ndaj një sjellje diskriminuese nga ana e Shoqërisë Albpetrol sh.a., duhet të ekzistojë një lidhje shkakësore ndërmjet shkaqeve të mbrojtura nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”¹⁴, për të cilat ankuesi pretendon diskriminim dhe trajtimit të pafavorshëm të tij.

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se Albpetrol sh.a.:

- *Në ndryshim nga punonjësit e tjerë të cilët nuk kanë paraqitur padi në organet gjyqësore me objekt diskriminimin, vetëm ankuesit i është kërkuar kthimi i dëmit të shkaktuar shoqërisë gjatë viteve 2016-2017, brenda afateve ligjore.*

Komisioneri vlerëson se nga ana e punëdhënësit, nuk u sollën argumenta ose prova për të hedhur poshtë pretendimin e ankuesit se kërkesa për kthimin e dëmit të shkaktuar, nuk ka ardhur si rezultat i ankimit të tij në Gjykatën e Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Fier.

Kodi i Procedurës Administrative, i ndryshuar, si dhe Kodi i Punës në ndryshimet e bëra, ka saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik, në këtë rast Shoqërisë Albpetrol sh.a. Pra, në këtë rast Shoqëria Albpetrol sh.a., duhet të provonte se subjekti ankues nuk është trajtuar në mënyrë të pabarabartë dhe më pak të favorshme.

Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.*

Kodi i Punës, i ndryshuar, në nenin 9, të tij ka parashikuar se: *“Në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, ndalohet çdo formë diskriminimi, e parashikuar në këtë Kod dhe në legjislacionin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi”.*

¹⁴ Në interpretim të nenin 1, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, *“...ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Ky parashikim është në të njëjtën frymë me parashikimet ligjore të LMD-së¹⁵. Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, është një ligj që rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, si dhe përcakton shkaqet në bazë të cilave ndaj një personi mund të ketë diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë. Gjithashtu në nenin 12 të ligjit 10221/2010 parashikohet se ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën për punësim, për shkaqet e parashikuara në nenin 1.

Ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, neni 12, pika 1, germa c), parashikon se: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: ...c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”*.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

Ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, neni 3, pika 8, parashikon se: *“Viktimizimi” është trajtim i disfavorshëm apo pasojë negative, që vjen si reagim ndaj një ankimi a një procedimi që synon zbatimin e parimit të barazisë”*.

Përsa më lart, fakti që punonjësit e tjerë të Shoqërisë Albetrol sh.a. për kthimin e dëmit të shkaktuar janë njoftuar përtej afateve ligjore, si dhe kthimi i dëmit të shkaktuar i është kërkuar brenda afateve vetëm ankuesit, pas ankimit të bërë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Fier prej tij, me pretendim diskriminimin gjatë procedurave të zgjidhjes së marrëdhënieve të punës, krijon dyshimin e arsyeshëm të trajtimit të tij në mënyrë të pabarabartë, në raport me punonjësit e tjerë të Shoqërisë Albetrol sh.a., me të cilët ndodhet në të njëjtat kushte.

Edhe pse veprimi kundrejt ankuesit rezulton i ligjshëm, kjo gjë nuk e shmang trajtimin e pabarabartë të Shoqërisë Albetrol sh.a. Marrja e vendimit me koshiencë të plotë nga kjo shoqëri për mos pretendimin e kthimit të shumave brenda afatit kundrejt subjekteve të tjerë në kushte të ngjashme me ankuesin, është një zgjedhje që kjo shoqëri ka vendosur në lidhje me këtë situatë konkrete, duke mos e rënduar kthimin e shumave tek punonjësit por duke e mbajtur atë barrë vetë. Kjo ide përforcohet edhe nga fakti që Shoqëria Albetrol

¹⁵ Referuar nenit 3, pika 8, e LMD-së.

sh.a., ka pasur eksperiencë dhe precedente¹⁶ të mëparshëm me situata të ngjashme kthimi shumë, çka do të thotë që vendimarrja e saj ka qenë krejtësisht e vetëdijshme.

Në këtë kontekst, marrja përsipër nga ana e Shoqërisë Albpetrol sh.a., e mbulimit të shumave për tu kthyer për të shtatë punonjësit duke trajtuar ndryshe vetëm ankuesin, i cili rezultoi i vetmi që ndërkohë kishte ngritur një padi kundër shoqërisë, krijon dyshimin e arsyeshëm se kjo sjellje është bërë vetëm për shkak të ankimit duke e vendosur atë në pozicionin e të viktimizuarit.

Në përfundim për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vlerëson se A. H., është ekspozuar ndaj një trajtimi të pabarabartë në formën e viktimizimit, nga ana e Shoqërisë Albpetrol sh.a., trajtim i cili ka ardhur si pasojë direkte pas ankimit të tij në Gjykatën e Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Fier, me pretendim diskriminim gjatë procedurave të zgjidhjes së marrëdhënieve të punës.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 1, 3/1/8, neni 7/1, neni 12, nenin 32, pika 1/a), c), si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit Nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit në formën e viktimizimit, të shtetasit A. H., nga ana e Shoqërisë Albpetrol sh.a., për shkak të ankimit¹⁷ të bërë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Fier.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Ankimi me diskriminim për shkak të bindjeve politike në organet gjyqësore)

(Fusha: Punësim)

¹⁶ Vendim i Gjykatës së Apelit Vlorë Nr. xx-xxx-xxxx (xxxx), datë 24.11.2015

¹⁷ Ankim me pretendim diskriminim për shkak të bindjeve politike nga Albpetrol sh.a., më datë 17.04.2018

Adresa: Rruga “Durrësit” (ish Ministria e Mjedisit), Tiranë , Tel: +355 4 2431078, E-mail: info@kmd.al, Web: www.kmd.al